

Data 05.11.2025

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impiantet përgjatë gazsjellësit TAP”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 35111500-0; 50324100-3; 50410000-2; 50531200-8; 73430000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,328,529 (katër milion e treqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekë pa tvsh dhe/ose 44,762.45 (dyzet e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë dyzet e pesë) Euro;

Llogaritur sipas Kursit Zyrtar të Këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 05.11.2025, ku vlera e Euros është 96.70.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
 - b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, në nenin 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të marreveshjes kuader.

Albanian Gas Service Company Sh.A.

Rruga “Kosovareve”, pallati NderPro Sh.P., Tirana, Albania

NUIS: L82407006D

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të marreveshjes kuader.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit të MK, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën me Kodin II.8.B “Shërbime ndërhyrëse higjienosanitare”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL), dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi i sipërcituar për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës. Shërbimi i verifikimit dhe testimi të sistemeve të zjarrit nuk mund të ofrohet nga çdo subjekt tregtar por vetëm nga ato subjekte të licencuara/autorizuara nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)ndaj duke qenë se kriteri është në proporcion me objektin e prokurimit të kësaj procedure vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet ta disponojnë dhe paraqesin këtë dokument.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit ose ekuivalente.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit ose ekuivalente.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ISO 45001, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit ose ekuivalente.

Të gjitha çertifikatat e mësipërme të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e funksionimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të detektimit, sinjalizimit dhe mbrojtjes nga zjarri pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën , OE duhet ta paraqesin ate.

Duke qenë se, shërbimet mirëmbajtjes së sistemit të detektimit, sinjalizimit dhe mbrojtjes nga zjarri të parashikuara në këtë kontratë do të realizohen në terren përgjatë shtrirjes së taubacionit të gazit TAP, ku ushtron aktivitet AGS sh.a , është e domosdoshme që operatorët ekonomikë ta

disponojnë edhe Standartin ISO 14001:2015 “Sistemi manaxhimit të mjedisit”. Kjo ISO është e lidhur me mjedisin dhe ndihmon në përmirësimin e imazhit të shoqërisë në lidhje me klientet e saj, komunitetin dhe autoritetet kontraktore. Në të njëjtën kohë manaxhimi i duhur i çështjeve lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndotjeve ndihmojnë në rritjen e konkurrencës së shoqërisë shoqëruar me uljen e shpenzimeve. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda më e thjeshtë dhe më efikasitet për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi menaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO14001. Perfitimet kryesore për këtë sistem menaxhimi janë: paraqitja e angazhimit për mbrojtjen e mjedisit nga klienti, investitorët potenciale, komuniteti, autoritetet; zvogëlimin e shpenzimeve nëpërmjet përmirësimit të administrimit mbeturinave dhe uljen e konsumit të burimeve; parandalimin e incidenteve të mundshme që mund të çojë në pagesën për dëmshpërblim dhe dëm; përmirësimin e marrëdhënieve me autoritetet; mundësi për hyrje në tregje të reja. Për sa më sipër, vendosja e kësaj ISO është në proporcion me objektin që AK po prokuron.

Standarti ISO 45001 përfaqëson një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të kompanisë me udhëzime për përdorimin e tij, për të mundur një organizatë që të përmirësojë në mënyrë proaktive performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të saj. Kjo ISO ka për qëllim të jetë e zbatueshme për çdo organizatë përfshirë dhe subjektet tregtare pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra e saj. Për më tepër, që në kriteret teknike AK ka kërkuar ndër të tjera që operatorët ekonomikë të disponojnë një staf të caktuar, minimal prej 5 punonjës, të cilët duhet të sigurojnë AK shërbimin e nevojshëm gjatë gjithë periudhës që do të shtrihet kontrata.

Gjithashtu argumentojmë se, politikat e AGS Sh.A. për sigurinë dhe shëndetin në punë kanë një rol thelbësor për të gjitha llojet e aktiviteteve që ushtrohen, kërkesë kjo si kontraktuale ndërmjet nesh edhe TAP ashtu edhe ndërmjet nesh edhe të gjithë palëve të treta (sic janë operatorët ekonomikë) që lidhin kontratë me AGS dhe do të kryejnë aktivitet furnizimi, trajnimi dhe shërbimi.

2.2.6 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të disponojë minimumi 5 (pesë) punonjës me kualifikimet dhe certifikimet si më poshtë.

- 1 (një) ekspert zjarrfikës të certifikuar sipas standardeve kombëtare ose ndërkombëtare i pajisur me Leje si “Ekspert privat zjarrfikës” lëshuar nga Drejtoria e MZSH e Ministrisë së Brendshme.
- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- 2 (dy) persona me eksperiencë në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri.
- 1 Drejtues Teknik, përgjegjës për mbikëqyrjen e plotë të punimeve dhe i pranishëm gjatë gjithë zbatimit të kontratës.

Punonjësit e mësipërm duhet të jenë të pajisur me certifikata/dëshmi për trajnime ndërgjegjësuere për të gjithë personelin, të cilat duhet të jenë lëshuar nga institucione trajnimi të licencuara ose të autorizuara nga Ministria e linjës në këto fusha:

- Certifikate trajnimi për mbrojtjen nga zjarri.
- Certifikate trajnimi për dhenien e ndihmes së shpejte.
- Certifikate trajnimi për sigurinë e paisjeve elektrike.
- Certifikate trajnimi për sigurinë e eneve në presion.
- Certifikate trajnimi për zonat ATEX (Atmosfere potencialisht Shperthyese).
- Certifikatë/dëshmi/raport që provon se është aftë për punë lëshuar nga mjeku.

Plotësimin e kërkesave të mësipërme, operatori ekonomik duhet ta provojë nëpërmjet dorëzimit të këtij dokumentacioni:

- i. Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore.
- ii. Listë pagesat e 3 tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- iii. Për ekspertin zjarrfikës, duhet të paraqitet certifikatat e lëshuar nga institucioni përkatës, kontrata e punës e vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës.
- iv. Për personin përgjegjës për HSE dhe pjesën tjetër të stafit duhet të dorëzohen certifikata/licenca, kontrata e punës të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës si dhe CV përkatëse.
- v. Certifikatat/dëshmi për trajnime ndërgjegjësuere të kërkuara duhen dorëzuar për çdo punonjës.

Kriteri do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, Shtojca nr.10 në DT. Dokumentat e kërkuara (i-v) do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, nga ofertuesi i kualifikuar i pari.

Argumentimi: Vendosija e këtij kriteri bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pikat 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesat e mësipërme mbështen edhe në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Referuar natyrës së shërbimeve që prokurohen sqarojmë se stafi teknik i kualifikuar profesionalisht është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen të cilat janë elektrike, mekanike etj. në tubacionin e gazit që ka një presion operimi prej 95 Bar, përfshirë edhe stacionet e valvulave dhe kompresorëve, ndaj AGSco e sheh të domosdoshme që për funksionimin e sigurtë të këtyre impianteve, për të ruajtur standardet e sigurisë së funksionimit dhe sigurinë e punonjësve që operojnë dhe mirëmbajnë këto impiante është d.m.d gatishmëria e personelit të kualifikuar të operatorit ekonomik fitues. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar

nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës

Gjithashtu për shkak se tubacioni është shtrirë në një territor të konsiderueshëm në Shqipëri dhe në vendet në zona shumë të largëta dhe për shkak të numrit të madh të impianteve të vendosura në vende të ndryshme, për të kryer shërbimet sipas specifikimeve teknike, kërkohet që numri minimal të jetë prej 5 personash, kualifikimet përkatëse dhe eksperiencia për aktivitetet që janë përshkruar në termat e referencës. Kontrolli dhe mirëmbajtja mund të kryhen në të njëjtën kohë në shumë stacione të valvulave dhe në stacionin e kompresorit dhe matjes, me vendndodhje të ndryshme gjeografike.

2.2.7 Operatori ekonomik për realizimin e kontratës duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike në pronësi ose qira për ekzekutimin e kontratës sipas tabelës më poshtë:

Aparate matëse		
1	Gas detektor personal	2
2	Auto laborator profesional të tipit (ATV), i cili do të mundësojë kryerjen e të gjithë shërbimit të kërkuar në impiant. Ky mjet duhet të realizojë rimbushjen dhe kolaudimin e fikseve të zjarrit të përshkruara në termat e referencës “AGS-TSP-001 - Fire and Gas Specifikime Teknike” dhe “ANEKSI 1 Te dhëna teknike të paisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri”.	1
3	Testues detektor tymi i pajtueshëm me pajisjet SOLO	1
4	Peshorja e kalibruar për peshën e fikseve të zjarrit	1
5	Pajisje për testimin e sensorëve të flakës. (Llampë testimi portabel)	1
6	Bombul për testimin e detektoreve të gazit të përshkruar në specifikimet teknike, e mbushur me gas kalibruar 2.5 % metan, e certifikuar. Bombola të jetë e pajisur me reduktorin përkatës në gjendje të sigurojë një kalim konstant gazi.	1
7	Matës presioni i kalibruar deri në 20 bar	1
8	Multimetër dixhital për matjen e tensionit DC, tensionit AC, rrymës DC, rezistencës, kapacitetit, frekuencës, temperaturës. Aparati duhet të jetë i pajisur me certifikate të vlefshme akreditimi.	1

Plotësimin e kërkesave të mesipërme, operatori ekonomik duhet ta provojë nëpërmjet këtij dokumentacioni:

- Për auto laboratorin në zërin 2, operatori ekonomik duhet të dorëzojë skedën teknike ku të specifikohen qartësisht proceset e punës për të cilat është prodhuar.

Në rast se mjeti është në pronësi, duhet të dorëzojë:

- dokumentin që vërteton pronësinë (certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- dokumentin që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

Në rast se mjeti nuk është në pronësi të ofertuesit duhet të dorëzojë:

- kontrata e qerese/huapërdorjes dhe cdo dokument provues
- dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi).

Per te gjitha pajisjet e tjera OE duhet të paraqesë fatura tatimore blerjeje, kontrata qiraje apo cdo dokument tjetër provues dhe bindes.

Kriteri do te konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit përmbledhës te vetëdeklarimit, Shtojca nr.10 në DT. Dokumentat e mësipërme qe provojnë disponimin e këtyre pajisjeve do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, nga ofertuesi i kualifikuar i pari.

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet ne piken 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën . Përsa i përket pajisjeve të kërkuara në tabelën e mësipërme argumentojmë se:

- Pajisja nr. 1 në tabelën e mësipërme është një detektor portabël gazi. Duke pasur në konsideratë që në brendësi të stacioneve të TAP ndodhet atmosferë potencialisht shpërthyes atëherë detektori i gazit është një pajisje e detyrueshme për të garantuar sigurinë e personelit që do të qëndrojë në brendësi të këtyre impianteve.
- Pajisja nr. 2, mjeti i lëvizshëm, nevoja për këtë mjet, auto laborator lind pasi mjeti duhet të parkohet jashtë çdo impianti në momentin që do të kryhet rimbushja/ricertifikimi i bombulave. Gjithashtu do të lejojë të realizohen riparime ose zëvendësime të pjesëve ose komponentëve të fikjeve të zjarrit në një kohë të shkurtër. Kjo do të lejojë një proces më të shpejtë ricertifikimi/rimbushjeje apo riparimi të fikseve të zjarrit, duke shmangur mungesën e fikseve në impiant dhe për rrjedhojë lënien e impiantit kritik pa mbrojtjen e projektuar nga zjarri.
- Grupi i pajisjeve 3 - 7 shërbejnë për kryerjen e aktiviteteve të përshkruara në specifikimet teknike dhe për të kryer testimin e pajisjeve të përshkruara në dokumentin (ANEKSI 1 Te dhena teknike te paisjeve dhe sistemeve te mbrojtjes nga zjarri)
- Paisja nr. 8 shërben për verifikimin e tensionit, rrymës, dhe të rezistencës është një pajisje që shërben për matjen dhe verifikimin e funksionalitetit të pajisjeve elektrike të përshkruara në specifikimet teknike.

I gjithë procesi do të monitorohet nga ekspertët e AGSCo dhe TAP, të cilët ndodhen pranë impaanteve në cdo ditë të vitit, në mënyrë që të garantohej nje rimbushje dhe kontroll në përputhje me standardet e sigurisë të mbrojtjes nga zjarri.

2.2.8 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se nëse do të shpallet fitues duhet te dorëzojë bashke me dokumentacionin e ofertes edhe Planin e sigurise dhe shendetit ne pune prefshire vleresimin e rrezikut specifik per aktivitetin e kesaj kontrate si dhe Metodologjine e punes (Method Statement) per proceset e punes përshkruar ne Termat e referencës:

- o Kontrolli i sistemit te alarmit te zjarrit
- o Kontrolli dhe rimbushja e fikseve të zjarrit portabël
- o Kontrolli i sistemit të fikjes me gaz inert (godina elektirke)

- Kontrolli i sistemit të fikjes së turbinave me CO₂ (sistemi mbrojtës i turbinave)
- Testi funksional hidranteve dhe rrjetit të hidranteve
- Kontrolli i tubave të hidranteve
- Kontrolli i rezervuarit të ujit në sistemin e zjarrit
- Kontrolli dhe testi funksional i pompës jockey
- Kontrolli dhe testi funksional i pompës elektrike
- Kontrolli dhe testi funksional i pompës diesel
- Kontrolli i sistemit të sprinklerave
- Kontrolli i sistemit të shkumës
- Kontrolli i daljeve emergjences dhe kontrolli i sinjalistikës së emergjences

Argumentimi: Vendosija e këtij kriteri bazohet në nenin 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Ligjin Nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, në VKM Nr. 107, datë 9.2.2011 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Paraqitja e këtij plani ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve, duke identifikuar dhe vlerësuar rreziqet në vendin e punës, si dhe duke përcaktuar masat parandaluese dhe korrigjuese për parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale. Planin shërben për të përmirësuar kushtet e punës, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të garantuar zbatimin e detyrimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Duke qenë se aktiviteti operacional që AK zhvillon ka rreziqe për sigurinë dhe shëndetin në punë, është e domosdoshme që operatori ekonomik të paraqesë edhe metodologjinë e punës ku të ketë të përshkruar mënyrën e sigurt, të kontrolluar dhe të standardizuar të kryerjes së një procesi pune, duke garantuar sigurinë, cilësinë dhe përputhjen me ligjin.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.2.9 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (ky kod është i publikuar në SPE së bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut të lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favorët e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t’i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të

njihen dhe marrin përsipër t'i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SHA që kanë lidhje me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

II. Argumentimi i termave të referencës dhe specifikimet teknike

Termat e Referencës dhe specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimit dhe afatin kohor për realizimin e këtij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.